



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 1435 prot.

Shkodër, më 27.04.2023

V E N D I M

Nr. 130, datë 27.04.2023

"Për disa ndryshime në Rregulloren e Studimeve në Universitetin e Shkodrës"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 38, pika 1, germa "d"; Statutit të USH-së Neni 17, pika 6, germa r; Rregullores së studimeve në USH, Udhëzimit nr. 13, datë 20.6.2022 "Për frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor dhe ciklit të studimit", Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 27.04.2023

Vendosi:

1. Të miratojë ndryshimet si më poshtë:

"1.Leksionet si rregull janë me frekuentim fakultativ. Njësitë kryesore mund të përcaktojnë në rregulloret e programeve të studimit frekuentim për lëndë/grup lëndësh të veçanta.

2.Ndjekja e seminareve/ushtimeve, laboratoreve dhe praktikave profesionale/klinike në programet e studimit me karakter profesional, programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit të ciklit të dytë dhe programet e studimit të ciklit të tretë "Master Ekzekutiv" është 75% e orëve.

Për programet e studimit të ciklit të tretë "Specializime afatgjata" dhe "Doktoratë" ndjekja është 50% seminare/ushtime, 75% për laboratorë dhe aktivitete profesionale/klinike/kërkimore-shkencore.

3.Studentët që nuk e plotësojnë këtë masë frekuentimi humbasin të drejtën për t'u futur në provim në atë lëndë. Ata kanë të drejtë të riprovohen në sezonin e riprovimit. Kjo u bëhet e njohur studentëve që në fillimin e vitit akademik.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARË
Prof. dr. Suzana GOLEMI